

13.04.2021

Ora 09:05

**RENDI I DITËS**

**Hedhja e shortit për “Përzgjedhjen e monitoruesit të Qarkut Lezhë”**

**PJESËMARRJA :**

**Stafi KQZ: Y.Merkaj, O.Peto**

**Z. Y. Merkaj:** Përshëndetje, sot në datën 13.04.2021, KQZ organizon shortin për zgjedhjen e monitoruesit të Qarkut të Lezhës. Komisioni i posaçëm i ngritur për verifikimin dhe plotësimin e kriterëve formale për aplikantët e monitoruesve, pasi ka shqyrtuar aplikimet, ka përzgjedhur listën prej 4 kandidatësh monitorues Qarku Lezhë. Të 4 kandidatët për monitorues plotësojnë kriteret e përcaktuara në Udhëzimin nr.1 të vitit 2021 të KQZ-së për procedurën e emërimit dhe objektin e monitorimit. Procedura e shortit është si më poshtë: Në një enë transparente do të futen 4 gogla me formë, peshë dhe ngjyrë të njëjtë, ku në secilën prej tyre do të futen shirita letre, ku janë shënuar emrat e aplikantëve për monitorues në Qarkun Lezhë. Fillojmë me procedurën e shortit. Emri i parë është Altin Gjoka, shiriti pasi futet në gogël hidhet në enën transparente. Emri i dytë është Sebastiano Gjetja, shiriti pasi futet në gogël hidhet në enën e tejdukshme, vazhdojmë me emrin e tretë Suada Shyti, e njëjta procedurë pasi paloset shiriti futet në gogël dhe hidhet në enën transparente. Vazhdojmë me aplikantin e katërt Shkëlzen Valgjeka edhe ky shirit paloset dhe futet në enë transparente. Pasi përzihen nga një përfaqësues i stafit, tërhiqet gogla dhe pasi hapet shiriti del emri Sebastiano Gjetja. Pra, i përzgjedhuri si monitorues i Qarkut Lezhë është zoti Sebastiano Gjetja, faleminderit!

**Vendimi nr.223**

**Zbardhi materialin audio  
Silvi SINO**

